REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
## SENATI AKADEMIK

Nr. 1737/2 Prot. Vlorë më, 23.09.2023

## VENDIM
## Nr.48 datë 29.09.2023

## PËR NJË NDRYSHIM NË FORMATIN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

Mbështetur ne nenin Nr.38, të Ligjit nr. 80/ 2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, nenin 19 në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali",Vlorë, Udhëzimin e MAS me nr. 19, datë 31.08.2023 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2023 "Për përcaktimin e elementeve përbërës , formën e diplomës ose çertifikatës së lëshuar nga IAL, dhe proçedurën e regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të diplomave dhe çertifikatave, për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor", të ndryshuar pika 1 gërma a, propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr. 1224, prot datë 15.09.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Zv Rektorit Akademik për një ndryshim në formatin e diplomës së lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, në pikën 9 të Vendimit nr.105, datë 20.11.2020 të Senatit Akademik, Vendimin nr. 39 datë 06.09.2022, Vendimin nr.32, pika 9 datë, 05.07.2021 si më poshtë:

   Pika 9

   **Ishte:** "Emri dhe mbiemri i Rektorit dhe Dekanit lihet bosh për tu plotësuar me shkrim dore"

   **Bëhet:** "Emri dhe mbiemri i Rektorit dhe Përgjegjësit të Njësisë Kryesore plotësohet me shtypshkrim dhe nënshkrimi plotësohet me shkrim dore".
2. Nje kopje e këtij vendimi i behet me dije Zëvendësrektorit Akademik dhe Njësive kryesore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**Prof.Dr. Roland ZISI**

Adresa /Adress. Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Ëeb-site: ëëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al